QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

NED
National Endowment for Democracy
Supporting freedom around the world

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

DEKONSTRUKTIMI I PERCEPTIMEVE PUBLIKE

Politika e jashtme e Kosovës dhe dialogu me Serbinë

DHJETOR 2018

QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

DEKONSTRUKTIMI I PERCEPTIMEVE PUBLIKE

Politika e jashtme e Kosovës dhe dialogu me Serbinë

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë(QKSS)

Autore: Donika Emini, Hulumtuese

Redaktor: Dr. Florian Qehaja, Drejtor Ekzekutiv

Përkrahur nga: National Endowment for Democracy (NED)

Dizajnuar nga: Arbër Matoshi

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura mbron të drejtat dhe pronën intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të marra nga të anketuarit dhe demonstrojnë vetëm mënyrën si i perceptojnë ata institucionet. Ky nuk është vlerësim përfundimtar i punës së institucioneve subjekt i këtij studimi. Raporti do t'u shërbejë si instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e fondacionit National Endowment for Democracy (NED)..

PËRMBAJTJA

GJETJET KRYESORE 6

HYRJE 8

KAPITULLI 1 - MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE: Kosova mes lidhjeve diplomatike komplekse dhe të vendosura mirë 11

1.1. PËRTEJ PARTNERITETIT: SHQIPËRIA NË SYTË E TË ANKETUARVE KOSOVARË 12

1.2. KOSOVA NË RAPORT ME MAQEDONINË DHE MALIN E ZI: NEUTRALITETI I ARTË 13

1.3. KOSOVA NË LIDHJE ME KROACINË DHE BOSNJE DHE HERCEGOVINËN: E KALUARA E PËRBASHKËT, E ARDHMJA E NDARË? 14

1.4. MARRËDHËNIET ME SERBINË: NË PRAG TË NJË LUFTE? 15

KAPITULLI 2 - FUQITË GLOBALE: Mes aleancave, partneriteteve dhe frikës 19

2.1. KOSOVA DHE SHBA: PERCEPTIMET PUBLIKE NDAJ NDIKIMIT TË SHBA-VE NË KOSOVË NËN ADMINISTRATËN E RE 20

2.2. KOSOVA DHE GJERMANIA: ALEATI MË I MADH POLITIK NË KUADËR TË BE-SË? 21

2.3. KOSOVA DHE TURQIA: NDIKIM I STRUKTURUAR DHE INTENSIV 22

2.4. KOSOVA DHE MBRETËRIA E BASHKUAR: A DO TI KEMI NË KRAHUN TONË? 23

2.5. KOSOVA DHE FRANCA: NË KËRKIM TË DINAMIKAVE TË REJA 24

2.6. KOSOVA DHE RUSIA: MES ARMIQËSISË DHE NDIKIMIT NEGATIV 24

KAPITULLI 3 - DIALOGU ME SERBINË: Lëvizja drejt etapës finale 27

3.1. FITIMTARËT DHE HUMBËSIT E DIALOGUT 28

3.2. ASOCIACIONI I KOMUNAVE SERBE: SKENARI I REPUBLIKA SRPSKA PËR KOSOVËN? 28

3.3. KUSH DUHET T'I JAPË DREJTIM? 29

3.4. FINALJA E MADHE: SHKËMBIMI I TOKAVE QË ÇON NË ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME? 31

KAPITULLI 4 - KOSOVA DHE MULTILATERALIZMI: A jemi gati? 33

4.1. KOSOVA DHE BE-JA: A PO BËN QEVERIA PËRPJEKJE TË MJAFTUESHME? 34

4.2. KOSOVA DHE NATO: PËRTEJ BASHKËVEPRIMIT TË ZGJERUAR 35

METODOLOGJIA 36

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË? 36

GJETJET KRYESORE

Ndër të gjitha vendet e renditura në pyetësor, **Shqipëria** perceptohet si vendi më miqësor ndaj Kosovës. 86.4 për qind kanë deklaruar qëkonsiderojnë Shqipërinë si partnerin dhe aleat kryesor strategjik të Kosovës. **Kroacia** është renditur si partneri i dytë rajonal strategjik për Kosovën pas Shqipërisë. Rreth 73.0 për qind e qytetarëve e kanë parë Kroacinë nga prizmi pozitiv. Kjo vërteton edhe një herë faktin se kosovarët e percepton Kroacinë si aleatin kryesor brenda BE.

Maqedonia ka shënuar rezultatin më të lartë në tre vitet e fundit, pothuajse gjysma e të anketuarve, 50 përqind e konsiderojnë atë si vend mik. Kjo mund t'i atribuohet drejtpërdrejt funksionimit të brendshëm të vendit pas zgjedhjeve të fundit dhe marrëdhënieve me komunitetin shqiptar në Maqedoni. Gjysma e të anketuarve, 48.1 përqind besojnë se **Mali i Zi** është një partner strategjik miqësor për Kosovën, ky perceptim pozitiv mund t'i atribuohet "durimit politik" të treguar në Podgoricë në lidhje me marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Kosovën.

Bosnja dhe Hercegovina është parë pozitivisht nga rreth 36.0 përqind e perceptojnë atë si një vend mik. Shumica dërrmuese ndajnë perceptimin negativ ndaj BeH duke marrë parasysh përafrimin e kësaj të fundit me Serbinë duke kundërshtuar fuqishëm pavarësinë e Kosovës dhe duke mos hezituar ta bllokojnë Kosovën në nismat rajonale.

Në prag të një lufte tjetër, kjo është fjala më e zakonshme e përdorur gjerësisht nga të anketuarit kur u kërkohet të kualifikojnë marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Rezultatet e KSB 2018 përsëri konfirmojnë faktin se mbi 85.0 përqind e të anketuarve e konsiderojnë Serbinë si një vend shumë armiqësor ndaj Kosovës. Përveç kësaj, Serbia konsiderohet si kërcënimi më i madh për sigurinë e jashtme për Kosovën.

Një shumicë e madhe e të anketuarve, rreth 86.0 përqind besojnë fuqishëm se **Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA)** janë partneri kryesor strategjik për Kosovën. Për më tepër, të anketuarit janë deklaruar haptazi në favor të përfshirjes së SHBA në procesin e dialogut me Serbinë. Për më tepër, mbështetja amerikane në përpjekjet për të përfunduar transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në forcat e armatosura ka pasur një ndikim të madh në formësimin e qëndrimit pozitiv në mesin e të anketuarve.

Gjermania është renditur në krye të të gjitha vendeve të BE-së, me 89.6 përqind të të anketuarve që perceptojnë Gjermaninë si aleatin kryesor strategjik brenda BE. Një nga faktorët kryesorë që qëndron pas këtij perceptimi pozitiv ka rrjedhur nga qasja e "tregut të hapur të punës" që Gjermania ka promovuar në Kosovë.

Rreth 70.0 për qind besojnë se **Turqia** është një partner miqësor ndaj Kosovës. Është shënuar një rënie në qasjen pozitive ndaj Turqisë. Faktorët që qëndrojnë pas kësaj rënie janë shumë të lidhura me rastin e gjashtë qytetarëve turq të arrestuar në Kosovë të akuzuar për lidhjet e tyre me Gylenin dhe të ekstraduar në Turqi me kërkesën e presidentit turk.

Mbretëria e Bashkuar është parë nga prizmi pozitiv prej 80.0 përqind të të anketuarve. Kjo reflekton pritshmëri të mëdha ndaj rritjes së numrit të programeve dypalëshe duke u fokusuar në forcimin e procesit të ndërtimit të shtetësisë në Kosovë. **Franca** është perceptuar kryesisht neutrale, hezitimi ndaj Francës mund t'i atribuohet rolit proaktiv të Francës në mbështetjen e idesë së shkëmbimit territorial, pasuar nga një marrëdhënie diplomatike e vakët midis Kosovës dhe Francës - veçanërisht për shkak të hezitimit të Francës në procesin e liberalizimit të vizave.

Rreth 80.4 për qind e respodentëve perceptojnë **Rusinë** si një vend shumë armiqësor ndaj Kosovës. Trendi negativ ndërlidhet me lidhjet e ngushta diplomatike në mes të Rusisë dhe Serbisë. Mbështetja e vazhdueshme nga Rusia i ka dhënë Serbisë një pozicionim të mirë negociues kudrejt BE-së. Ky pozicionim është konsideruar si faktori kyç i përfitimeve politike të kufizuara deri në inekzistente për Kosovën nga ky proces.

Kur pyeten se kush përfiton më shumë nga dialogu, në mesin e të anketuarve është shumë e pranishme një tendencë për të renditur palën tjetër si fitimtare. Paranoja kolektive e krijuar nga mungesa e transparencës ka krijuar perceptimin se dialogu po sjell përfitime politike vetëm për "kundërshtarët". Andaj, pothuajse gjysma e të anketuarve kanë deklaruar se Serbia po përfiton më shumë se Kosova në këtë proces.

Në sytë e të intervistuarve shqiptarë të Kosovës, Asociacioni i Komunave me shumicë serbe shihet si një skenar i Republikës Srpska për Kosovën.

Për më tepër, ka ngritur shqetësime mbi ndikimin e ardhshëm në funksionimin e brendshëm të Kosovës, duke u perceptuar si plani i Beogradit për të zgjeruar ndikimin e vet politik në Kosovë. Andaj, pothuajse 80.0 për qind e të anketuarve besojnë se asociacioni përbën rrezik të drejtpërdrejtë për funksionimin e brendshëm të Kosovës si shtet.

Duke përcjellur debatin se kush do të duhej të udhëheq dialogun me Serbinë. Duke ju përgjigjur një pyetje të hapur, rreth 15.0 për qind besojnë se dialogu duhet të udhëhiqet nga Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi. Pak më pak mbështetje ka marrë Albin Kurti nga partia politike Vetëvendosje, me 11.5 për qind të të anketuarve që besojnë se është shumë i aftë dhe në gjendje ta udhëheqë dialogun. Fakti që shumica dërrmuese e të anketuarve kanë sugjeruar udhëheqës në vend të institucione shtetërore, si Qeveria me 4.24 për qind dhe Kuvendi me 5.71 për qind, është një tregues kyç i domosdoshmërisë për të pasur "burra të fortë" në proces.

Shumica dërrmuese e të anketuarve, pothuajse 81.0 përqind e qytetarëve kanë deklaruar se shkëmbimi i territoreve nuk do të ofrojë zgjidhje afatgjatë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ata që i janë përgjigjur po idesë për shkëmbim territorial, kanë ndjekur diskursin e Presidentit për shkëmbimin e pjesës veriore të Kosovës me pjesën jugore të Serbisë.

Ende në favor të procesit të integrimit në BE, gjysma e të anketuarve besojnë se Qeveria e Kosovës nuk po ndjek me sukses agjendën e saj të integrimit në BE. Ky zhgënjim ka qenë i pranishëm pas procesit të liberalizimit të vizave dhe zbatimit të kufizuar të MSA-së.

Mbi 82.0 përqind e të anketuarve kanë deklaruar të jenë pro anëtarësimit në NATO. Ky qëndrim është thellësisht i rrënjosur në ndërhyrjen e NATO-s në ish-Jugosllavi dhe në misionin e KFOR-it si një nga ofruesit kryesorë të sigurisë krahas FSK-së.

HYRJE

Në dhjetë vitet e fundit, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës (2018), sistemi ndërkombëtar ka pësuar ndryshime të mëdha. Multilateralizmi - platforma e vetme ku shtetet e vogla kanë pasur mundësinë të gëzojnë më shumë fuqi dhe prestigj - po hidhet poshtë dalë ngadalë, teksa mekanizmat ndërkombëtarë, që dikur ishin të suksesshëm, po përballen me sfida serioze. Këto zhvillime kanë pasur një ndikim të fortë në konstelacionin politik ndërkombëtar. Për më tepër, kjo e shton më tej kompleksitetin e Kosovës që ende kërkon njohje ndërkombëtare dhe anëtarësim në mekanizmat kyç ndërkombëtarë.

Në vitin 2018, Kosova shënoi 10 vjetorin e pavarësisë së saj. Ky moment historik bëri thirrje për reflektim mbi progresin në përfundimin e procesit të shtet-ndërtimit, sfidat në funksionimin e brendshëm të vendit në aspekte të ndryshme duke filluar nga trendet dhe zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore. Mes çështjeve të shumta të diskutueshme me rastin e dhjetë vjetorit, politika e jashtme e Kosovës është renditur si prioritet kryesor nga politikë-bërësit dhe komuniteti i think tank. Njohjet ndërkombëtare, shtetet e BE-së që nuk e njohin Kosovën dhe mungesa e suksesit në arritjen e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare vazhduan ta vënë në provë diplomacinë kosovare. Për më tepër, dhjetë vjet pas pavarësisë Kosova po lufton me një fenomen të ri, faktorin e "tërheqjes së njohjes" që ka hapur fronte të reja diplomatike me Serbinë. Çka e bën situatën edhe më komplekse është se në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja me Serbinë, dhjetë vjet pas pavarësisë së Kosovës dhe tetë vjet pas vendimit të GJND-së për këtë çështje, Kosova ka hapur kapitullin e shkëmbimit të territoreve ose ndarjes potenciale - agjenda politike që më së paku është pritur të ndiqet nga Kosova - duke shkaktuar shumë debate në opinionin publik.

Duke u përballur me sfida në disa fronte diplomatike, diplomacia e Kosovës e gjendur ende në fazën e konsolidiimit nuk ka demonstruar kapacitete serioze për adresimin me sukses të të gjitha sfidave të lartpërmendura. Fokusi dhe përpjekjet kryesore në politikën e jashtme janë orientuar drejt dialogut me Serbinë të lehtësuar nga BE-ja, dhe rrjedhimisht dialogu u kthye në faktorin kyç dhe të vetëm për politikën e jashtme të Kosovës. Dialogu në vazhdim me Serbinë i ka lënë pezull njohjet ndërkombëtare, e ka bërë politikën e jashtme të Kosovës të varur plotësisht nga Serbia, dhe çka është më shqetësuese ka rihapur debatin për territorin dhe statusin e Kosovës.

Arratia e politikës së jashtme të diplomacisë së sapokrijuar të Kosovës ka marrë një kthesë mjaft dramatike. Kosova ka fituar një numër relativisht të ulët të njohjeve ndërkombëtare gjatë viteve të fundit, ndërkohë që dhjetë vjet pas pavarësisë ende përpiqet të marrë njohjen nga pesë shtetet anëtare të BE-së, kurse anëtarësimi në OKB është një objektiv shumë i largët i politikës së jashtme, duke pasur parasysh opozitën e fortë të Kinës dhe Rusisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Arritja e rezultateve të favorshme në politikën e jashtme, si marrja e njohjes dhe vendosja e marrëdhënieve dypalëshe, ka qenë mision i pamundur për diplomacinë e Kosovës. Për shkak të krizave të brendshme politike të vazhdueshme dhe cikleve të shpeshta zgjedhore në Kosovë, procesit të zgjatur dhe rraskapitës të dialogut me Serbinë, të shoqëruar me ndryshimin në rendin global, Kosova e ka pasur më të vështirë të arrijë rezultate të prekshme në politikën e jashtme. Nga ana tjetër, anëtarësimi në mekanizma të tjerë ndërkombëtarë duket se ka mbetur pezull për Kosovën, për shkak të mungesës së qasjes proaktive të qeverisë dhe fushatës agresive kundër Kosovës të udhëhequr nga Serbia.

Kundrejt këtij sfondi, politika e jashtme nuk duket të jetë vetëm shqetësim i politikëbërësve dhe i komunitetit të instituteve studimore, por edhe i qytetarëve të zakonshëm. Duke i përcjellur reagimet e forta nga opinioni publik, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë vazhdon me shqyrtimin e rezultateve të opinionit publik mbi çështjet më të gjera të politikës së jashtme dhe dialogut me Serbinë, në formën e Edicionit të Posaçëm të Programit të Barometrit Kosovar të Sigurisë. Për të siguruar vlerësimin e trendeve, pyetjet kryesore të anketës mbetën të pandryshuara. QKSS-ja vazhdon të masë mënyrën se si i shohin qytetarët e Kosovës partnerët e saj strategjikë rajonalë dhe ndërkombëtarë, si i percepton një qytetar mesatar i Kosovës ndikimet e jashtme në Ballkanin Perëndimor dhe në Kosovë në mënyrë specifike, dhe cili është opinioni ndaj anëtarësimit në BE dhe NATO. Ngjashëm me edicionet e mëparshme, QKSS-ja është përqendruar veçanërisht në dialogun e lehtësuar nga BE-ja me Serbinë. Megjithatë, pas debateve mbi epilogun e mundshëm të dialogut, QKSS-ja ka përfshirë pyetje shtesë në lidhje me marrëveshjet detyruese ligjore dhe kryenegociatorin e Kosovës.

Në vijim, edicioni i posaçëm mbulon dimensionet e mëposhtme:

- Perceptimet e publikut ndaj aktorëve relevantë rajonalë dhe ndërkombëtarë;
- Perceptimet e publikut ndaj ndikimeve të jashtme në Kosovë dhe aleancave euro-atlantike;
- Perceptimet e publikut ndaj dialogut të lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë

KËRKIMI I PARTNERËVE STRATEGJIK

BILATERALIZMI DHE MULTILATERALIZMI NË SYTË E KOSOVARËVE

PARTNERËT DHE ALEATËT KRYESOR STRATEGJIK TË KOSOVËS



KAPITULLI 1

MARRËDHËNIET E MIRA FQINJËSORE: Kosova mes lidhjeve diplomatike komplekse dhe të vendosura mirë

Ballkani Perëndimor është rajon i paqëndrueshëm; shumë shtete të rajonit ende kanë mosmarrëveshje të pazgjidhura dypalëshe. Mosmarrëveshjet e vazhdueshme mbeten pengesa të pakapërcyeshme, kështu që bashkëpunimi mes shteteve të Ballkanit mbetet i kufizuar - me disa që kanë vendosur embargo ekonomike ndaj njëri-tjetrit. Përveç kësaj, liria e lëvizjes, lëvizshmëria dhe komunikimi mes qytetarëve mbeten ndër sfidat kyçe. Për të nxitur dhe lehtësuar bashkëpunimin në Ballkanin Perëndimor janë lansuar shumë projekte dhe nisma të BE-së. Për më tepër, marrëdhëniet e mira fqinjësore kanë qenë pjesë integrale e procesit të integrimit në BE, pasi ky parim u përkthye në një kusht të rëndësishëm të anëtarësimit në politikën e zgjerimit të BE-së.

Në rastin e Kosovës, bashkëpunimi rajonal është një proces edhe më sfidues, duke i munguar njohja nga dy shtete rajonale si Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, të cilat nuk kanë hezituar aspak të bllokojnë pjesëmarrjen e Kosovës në platformat rajonale. Mungesa e lirisë së lëvizjes dhe embargo ekonomike e shtojnë më tej kompleksitetin e frymës rajonale. Nga ana tjetër, bashkëpunimi i Kosovës me shtetet e rajonit që e kanë njohur mbetet në nivel të kënaqshëm, megjithëse sfidohet nga ngjarjet politike që ndodhin në mënyrë sporadike, si marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi.

Lista e shteteve rajonale të përfshira në anketë ka mbetur e pandryshuar nga edicionet e mëparshme; ajo përbëhet nga shtetet fqinje që ndajnë kufijtë e tyre me Kosovën, dhe që janë Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Përveç tyre, ekipi i hulumtuesve të QKSS-së konsideroi edhe përfshirjen e Bosnje dhe Hercegovinës në anketë, kryesisht për shkak të mungesës së lidhjeve diplomatike dhe qëndrimit të saj në përputhje me Serbinë në raport me Kosovën; si dhe të Kroacisë, për shkak të mbështetjes së saj të në procesin e shtet-ndërtimit, politikën e mbrojtjes dhe të jashtme të Kosovës, por edhe si aleate strategjike në kuadër të BE-së.

Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin marrëdhëniet diplomatike dhe qëndrimin e këtyre shteteve ndaj Kosovës, duke iu ofruar një spektër të vlerësimit që shkon nga cilësimet negative si shumë armiqësore dhe armiqësore, tek pozicionimi neutral dhe vlerësimi pozitiv si miqësore dhe shumë miqësore. Shtetet e përfshira në anketë janë grupuar qëllimisht, bazuar në gjetjet kyçe të këtij edicioni të BKS 2018. Kapitulli fillon me shtetin me marrëdhënie më intensive me Kosovën, pra Shqipërinë, dhe vijon me Maqedoninë dhe Malin e Zi, për të cilët të anketuarit duket se kanë mendime mjaft neutrale. Më tej, vazhdohet me Bosnje dhe Hercegovinën dhe Kroacinë, të cilat edhe pse nuk kanë kufij të përbashkët me Kosovën, janë të rëndësishme për opinionin publik dhe për politikën e jashtme të Kosovës. Së fundi, trajtohet Serbia që është kualifikuar si një shtet shumë armiqësor ndaj Kosovës.

1.1. Përtej partneritetit: Shqipëria në sytë e të anketuarve kosovarë

Ndër të gjitha shtetet e renditura në pyetësor, Shqipëria perceptohet si shteti më miqësor ndaj Kosovës. Trendi i qëndrimit pozitiv ndaj Shqipërisë mbetet pothuajse i pandryshuar nga edicionet e mëparshme të BKS-së. Rezultatet e BKS 2018 tregojnë se një shumicë e madhe e të anketuarve, 86.4 për qind, kanë deklaruar se e konsiderojnë Shqipërinë si partnerin dhe aleatin kryesor strategjik të Kosovës. Është e domosdoshme të përmendet se ky perceptim pozitiv nuk është i pranishëm në mesin e të anketuarve serbë, prandaj perceptimi negativ ndaj Shqipërisë është kryesisht i pranishëm në mesin e të intervistuarve serbë të Kosovës.

Një shqyrtim më nga afër i shtysave dhe faktorëve kryesorë që formojnë opinionin publik ndaj Shqipërisë tregon se elementi më i fuqishëm që qëndron pas perceptimit pozitiv është thellësisht i rrënjosur në ndjenjat e përbashkëta kombëtare, historike dhe tradicionale. Reagimet cilësore nga hulumtuesit në terren tregojnë se Shqipëria është shteti më i frekuentuar nga kosovarët, andaj një pjesë



Figura 1 - Perceptimet ndaj Shqipërisë

e madhe e perceptimeve janë zhvilluar ndër vite dhe bazohen në përvojën personale të të anketuarve. Përveç kësaj, bashkëpunimi i gjerë kulturor i ka zbehur kufijtë mes Kosovës dhe Shqipërisë. Në retrospektivë, ky ka qenë bashkëpunimi i parë dhe më i suksesshëm mes Kosovës dhe Shqipërisë, dhe nuk ka kaluar pa u vënë re nga të anketuarit.

Përveç elementeve të lartpërmendura, reagimet e mbledhura përmes grupeve të fokusit me hulumtuesit në terren konfirmojnë se aspekti politik luan një rol vendimtar në perceptimet pozitive. Shqipëria mbetet i vetmi shtet i rajonin që mbështet plotësisht dhe pa hezitim ndërmarrjet politike të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Kjo vlen për pjesëmarrjen e Kosovës në platformat rajonale, në të cilat Shqipëria është angazhuar në mënyrë proaktive për përfshirjen e Kosovës, gjithashtu në mbështetje politike të aspiratës së Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Pavarësisht nga rezultati përfundimtar që rrjedh nga ky bashkëpunim, kuptimi simbolik që qëndron pas këtyre përpjekjeve ka më shumë rëndësi sesa rezultati përfundimtar i prekshëm në sytë e të anketuarve.

Nga ana tjetër, intensiteti i takimeve bilaterale Kosovë - Shqipëri në të gjitha nivelet e politikëbërësve, shoqërisë civile dhe mediave ka luajtur një rol qendror në këtë drejtim. Ndërsa angazhimi proaktiv i profesionistëve të rinj nga Kosova në kuadër të qeverisë së Shqipërisë ka krijuar një perceptim se Shqipëria mbështet dhe ofron platforma solide për kosovarët për zhvillimin e karrierës së tyre në politikë përtej kufijve. Angazhimi i një numri profesionistësh të rinj, kryesisht të ardhur nga sfondi i shoqërisë civile, të cilët u bënë pjesë e qeverisë e Shqipërisë duke punuar si zëvendësministra, jo vetëm që kontribuoi në shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës, por është parë si një rrugë e mirë për të nxitur bashkëpunimin dypalësh mes Kosovës dhe Shqipërisë. Për më tepër, kosovarët u angazhuan aktivisht në sektorë kyç si politika e jashtme, arsimi, turizmi dhe shëndetësia, ku bashkëpunimi i zgjeruar mes dy shteteve është thelbësor për të ardhmen e afërt.

Ndryshe nga perceptimet pozitive, rreth 5.0 për qind e të anketuarve kanë ndarë perceptime neutrale ndaj Shqipërisë, dhe këto hezitime kanë qenë më të pranishme në mesin e shqiptarëve të Kosovës që kanë shfaqur qasje skeptike ndaj qeverisë aktuale në Shqipëri. Reagimet nga terreni tregojnë

se ky hezitim i atribuohet perceptimit se Shqipëria po e përdor Kosovën politikisht për të rifituar rëndësi në rajon - në raport me Serbinë, por edhe ndaj BE-së. Ndërsa një pjesë e vogël e të anketuarve ose 7.0 për qind - nëse i shprehim në shifra - besojnë se Shqipëria është një vend armiqësor ndaj Kosovës, dhe kjo qasje ka qenë më e pranishme në mesin e serbëve të Kosovës. Në rastet kur kjo përgjigje u dha nga shqiptarët e Kosovës, arsyetimi ishte i rrënjosur në frikën e "rivendosjes së marrëdhënieve politike mes Serbisë dhe Shqipërisë", si dhe në reagimin mjaft të paqartë dhe të vonuar ndaj zhvillimeve të reja në kuadrin e dialogut të lehtësuar nga BE-ja me Serbinë dhe marrëveshjes së mundshme që do të përfshinte shkëmbim territoresh.

1.2. Kosova në raport me Maqedoninë dhe Malin e Zi: neutraliteti i artë

Maqedonia dhe Mali i Zi janë renditur si shtete mjaft neutrale ndaj Kosovës. Perceptimet e qytetarëve ndaj këtyre shteteve kanë lëvizur përgjatë të njëjtave linja si në edicionet e kaluara, duke mos treguar ndryshime të rëndësishme në qëndrimin e të anketuarve. Siç është treguar në figurat 2 dhe 3, në pyetjet për Maqedoninë dhe Malin e Zi perceptimet e përgjithshme mbeten pozitive, me një lëvizje të lehtë drejt pozicionimit të tyre neutral ndaj Kosovës.

Kur u pyetën për Maqedoninë, përqindja e të anketuarve që e kanë cilësuar si miqësore ndaj Kosovës ka shënuar rezultatin më të lartë në tre vitet e fundit. Me pothuajse gjysmën e të anketuarve, 50 për qind, është e qartë se Maqedonia është parë nën një prizëm më pozitiv që mund t'i atribuohet drejtpërdrejt funksionimit të brendshëm të vendit pas zgjedhjeve të fundit. Ndryshimi i konstelacionit politik në Maqedoni dhe ristrukturimi i pozicionit politik ndaj komunitetit shqiptar në kuadër të qeverisë, mund të renditen si faktorë kyç në këtë perceptim. Politika e jashtme maqedonase shihet si më progresive sesa e mëparshmja. Ndryshimi i qëndrimit është reflektuar në qëndrimin e Maqedonisë ndaj disa ngjarjeve kyçe politike që përfshijnë Kosovën, veçanërisht në debatin politik të lidhur me shkëmbimin e territoreve me Serbinë. Përveç kësaj, shpeshtësia e lëvizshmërisë mes qytetarëve dhe e bashkëpunimit tregtar - veçanërisht në zonat kufitare - është renditur si një arsye tjetër e rëndësishme e përdorur gjerësisht nga të anketuarit në reagimet e tyre cilësore.

Një pjesë e madhe e të intervistuarve, rreth 39.0 për qind besojnë se Maqedonia mbetet neutrale ndaj Kosovës. Për ata që e kanë zgjedhur këtë alternativë, Maqedonia ka ndërmarrë një hap serioz për faktin e thjeshtë se renditet në grupin e parë të shteteve që e njohën Kosovën, megjithatë ata nuk shohin angazhim më të thellë në bashkëpunimin dypalësh mes dy shteteve.

Ky edicion ka dëshmuar një rënie të ndjeshme në përqindjen e atyre që e konsiderojnë Maqedoninë si shtet armiqësor, më konkretisht nga 20.0 për qind në vitin 2016 ka rënë në 13.5 për qind në vitin 2017, duke vazhduar të bjerë në më pak se 8.0 për qind në vitin 2018. Faktorët ndikues tek ata që e konsiderojnë Maqedoninë një shtet armiqësor janë të lidhura me shqetësimin për pozicionimin e komunitetit shqiptar në Maqedoni, dhe janë nxitur nga debate të gjera për ligjin e gjuhëve - i cili u miratua pas shumë përpjekjeve të dështuara.

Ngjashëm me edicionet e mëparshme të BKS-së, tendencat e perceptimit të qytetarëve ndaj Malit të Zi mbeten të pandryshuara. Përqindja e të anketuarve që besojnë se



Figura 2 - Perceptimet ndaj Maqedonisë



Figura 3 - Perceptimet ndaj Malit të Zi

Mali i Zi është shtet miqësor ndaj Kosovës është rritur ndjeshëm. Gjysma e të anketuarve, 48.1 për qind besojnë se Mali i Zi është partner strategjik miqësor për Kosovën, dhe ky perceptim pozitiv mund t'i atribuohet "durimit politik" të treguar nga Podgorica në lidhje me marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Kosovën. Reagimet cilësore tregojnë se qytetarët e kanë parë problemin në kontekstin e fërkimeve të brendshme mes elitës politike në Kosovë - qeverisë dhe opozitës - dhe jo si një mosmarrëveshje e hapur bilaterale me Malin e Zi.

Qasja neutrale e shprehur nga rreth 37.1 për qind e të anketuarve mund t'i atribuohet lëvizshmërisë dhe lidhjeve të ngushta me komunitetin shqiptar që jeton në Mal të Zi. Për më tepër, ajo është e rrënjosur në vendimin e Malit të Zi që ta njohë Kosovën në vitin 2008, edhe pse bashkëpunimi dypalësh mbetet i kufizuar dhe në margjinat e bashkëpunimit tregtar. Nga ana tjetër, një përqindje e vogël e të anketuarve prej më pak se 9 për qind e perceptojnë si armiqësore qasjen e Malit të Zi ndaj Kosovës.

1.3. Kosova në lidhje me Kroacinë dhe Bosnje dhe Hercegovinën: e kaluara e përbashkët, e ardhmja e ndarë?

Përfshirja e Kroacisë në pyetësor është konsideruar e domosdoshme, pasi bashkëpunimi dypalësh mes Kosovës dhe Kroacisë ka qenë i qëndrueshëm, intensiv dhe i pranishëm në sektorët kyç, përfshirë këtu politikën, sigurinë, ekonominë dhe mbrojtjen. Është e domosdoshme të theksohet rritja domethënëse në përqindje e të anketuarve që e perceptojnë si shumë miqësor qëndrimin e Kroacisë ndaj Kosovës. Ndër të gjitha shtetet e rajonit të listuara në pyetësor, Kroacia është renditur si partneri i dytë strategjik rajonal për Kosovën pas Shqipërisë. Rreth 73.0 për qind e qytetarëve e shohin Kroacinë përmes një prizmi pozitiv. Ky qëndrim i gjerë pozitiv është ngulitur në mbështetjen afatgjatë politike, bashkëpunimin në sektorin e mbrojtjes dhe përkrahjen e përgjithshme të Kroacisë në përpjekjet



Figura 4 - Perceptimet ndaj Kroacisë

e Kosovës për anëtarësim në platformat e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Përqindja e atyre që e konsiderojnë Kroacinë si neutrale është rreth 12.0 për qind, pasuar nga rreth 11.0 për qind që e shohin nga këndvështrim negativ. Qëndrimi neutral shpjegohet nga të anketuarit kryesisht përmes nivelit të lartë të pritshmërive nga Kroacia, e cila sipas tyre, në kuadër të BE-së, në përgjithësi ka një qasje të vakët të ndaj Ballkanit Perëndimor.

Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova ndajnë një histori mjaft komplekse. Teksa qëndrimi i përgjithshëm politik ndaj Kosovës në mesin e entitetit boshnjak është zbutur në vitet e fundit, pozicionimi i zëshëm i udhëheqësve të Republika Srpska ka çuar në një ndikim shqetësues serb në politikën ndaj Kosovës.

Duke marrë parasysh mungesën e bashkëpunimit diplomatik dhe marrëdhëniet e bllokuara me BeH, kur u kërkohet të vlerësojnë qëndrimin e këtij shteti ndaj Kosovës, një pjesë mjaft e madhe e të anketuarve, rreth 36.0 për qind, e perceptojnë si shtet miqësor. Vetëm 12.7 për qind e të anketuarve besojnë se është neutrale ndaj



Figura 5 - Perceptimet ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës

Kosovës. E shkuara dhe fati i ngjashëm, veçanërisht në lidhje me agresionin serb, mund të renditet si elementët kyç që mbështesin qëndrimin pozitiv, kryesisht të bazuar në dhembshuri. Një arsye tjetër pas këtyre rezultateve ka të bëjë me faktin se qytetarët janë të vetëdijshëm për kompleksitetin e Bosnjës, prandaj mund të bëjnë dallim të qartë mes qëndrimit të përgjithshëm të Bosnjës ndaj Kosovës dhe bllokadës së nxitur dhe ndikuar nga njësia federale serbe - Republika Srpska.

Kur pyeten për BeH-në, rreth 17.5 për qind e të anketuarve kanë perceptime negative, kryesisht duke iu referuar ndikimit serb, mungesës së marrëdhënieve dypalëshe, mungesës së lirisë së lëvizjes së mallrave dhe qytetarëve. Më e rëndësishmja, qëndrimi i lidhur me Serbinë në raport me pavarësisë së Kosovës ka luajtur një rol kyç në formimin e perceptimit negativ ndaj BeH-së.

1.4. Marrëdhëniet me Serbinë: në prag të një lufte?

"Në prag të një lufte tjetër" është fjalia më e zakonshme e përdorur gjerësisht nga të anketuarit kur u kërkohet të cilësojnë marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Rezultatet e BKS 2018 konfirmojnë sërish faktin se mbi 85.0 për qind e të anketuarve e konsiderojnë Serbinë si shtet shumë armiqësor ndaj Kosovës. Përveç kësaj, Serbia dallohet si kërcënimi më i madh i jashtëm për sigurinë e Kosovës.

Qasja negative e Serbisë ndaj Kosovës buron nga një konflikt të rrënjosur thellë, i kaluar brez pas brezi, dhe disa dhjetëvjeçarëve të marrëdhënieve të tensionuara mes Kosovës dhe Serbisë. Këto perceptime bazohen në përvojat personale të shumicës dërrmuese të të anketuarve që kanë qenë të pranishëm gjatë luftës së vitit 1999, dhe kanë vazhduar të dëshmojnë qasjen armiqësore të Serbisë ndaj Kosovës në procesin e shtet-ndërtimit.

Reagimet cilësore nga hulumtimet në terren tregojnë se qytetarët e perceptojnë qasjen negative të Serbisë ndaj Kosovës në tri rryma të ndryshme. Së pari, përmes betejës diplomatike në arenën ndërkombëtare dhe lojës së kompetencave në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Në këtë drejtim, të anketuarit besojnë se roli pengues i Serbisë ka pasur një ndikim të madh në procesin e njohjeve

ndërkombëtare dhe tërheqjes së njohjeve nga shtete kryesisht afrikane, si dhe në mungesën e progresit në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Së dyti, faktori "Lista Serbe", partia serbe me shumë ndikim, e cila është e integruar në kuadër të qeverisë aktuale të Kosovës. Në sytë e të anketuarve, "Lista Serbe" funksionon nën direktivat e Beogradit dhe përdor pushtetin politik dhe privilegjet e siguruara nga Pakoja e Ahtisarit për ta bërë Kosovën jofunksionale nga brenda, duke bllokuar pothuajse çdo iniciativë të politikëbërjes në shkallë të gjerë. Kërcënimet e njëpasnjëshme të "Listës Serbe" për ta lëshuar qeverinë, të cilat çojnë në zgjedhje të parakohshme, kanë kontribuar më tej në perceptimin e përgjithshëm të ndikimit dhe pushtetit të saj politik në Kosovë. Së treti, retorika agresive nacionaliste nga politikanët serbë ka vërtetuar një nga supozimet më shqetësuese të të anketuarve shqiptarë të Kosovës; kjo riafirmoi faktin se Serbia nuk do ta zbusë qëndrimin e saj ndaj Kosovës në periudhën afatshkurtër.

Argumenti kyç i atyre që e cilësojnë Serbinë si një shtet shumë armiqësor, është epilogu i dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Kthesa e papritur që mori dialogu në prag të hulumtimit në terren dhe debati mbi marrëveshjen e shkëmbimit të territoreve ose të tokave, kanë forcuar më tej perceptimet negative ndaj Serbisë, ndërkohë që frika se do shkaktojë një konflikt tjetër është rritur pafundësisht.

Një përqindje e vogël e të anketuarve, mesatarisht rreth 8.0 për qind besojnë se Serbia është shtet miqësor ndaj Kosovës. Pa dyshim, ky perceptim është i pranishëm në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës. Përgjigjja e dhënë mund të bazohet edhe në praninë e përgjithshme të Serbisë, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës, nëpërmjet institucioneve paralele serbe që ofrojnë shërbime dhe gjenerojnë të ardhura për komunitetin serb.



Figura 6 - Perceptimet ndaj Serbisë



Figure 7 - Ndikimi i Serbisë në Kosovë

PARTNERËT DHE ALEATËT NDËRKOMBËTAR KRYESOR STRATEGJIK TË KOSOVËS



SHTETET NDËRKOMBËTARE ME MË SHUMË INFLUENCË NË KOSOVË



KAPITULLI /2

FUQITË GLOBALE:
Mes aleancave, partneriteteve dhe frikës

Sërish, rajoni po shndërrohet në një fushë shahu gjeostrategjik për aktorë të shumtë të jashtëm që kërkojnë të zgjerojnë prezencën dhe ndikimin e tyre në rajon. Përveç agjendës së BE-së, për të cilën të gjitha shtetet e Ballkanit, duke përfshirë Kosovën, janë deklaruar të paktën formalisht se e ndjekin në mënyrë proaktive, një numër faktorësh të tjerë të jashtëm, siç janë Rusia, Kina, Turqia dhe shtetet e Gjirit Persik, janë duke rritur ndikimin e tyre politik, ekonomik dhe kulturor në rajon me një gamë të gjerë burimesh, synimesh dhe interesash. Prania e Shteteve të Bashkuara dhe zgjerimi i NATO-s, edhe pse në përputhje me agjendën e BE-së apo Perëndimore, vazhdon të marrë një pjesë të madhe të vëmendjes, jo vetëm të politikëbërësve dhe elitave politike, por edhe të opinionit publik në përgjithësi.

Pozicionimi ndërkombëtar i Kosovës dhe shpeshtësia e marrëdhënieve diplomatike mes Kosovës dhe fuqive të mëdha janë shumë të diskutuara në opinionin publik në Kosovë. Përcjellja e vëmendshme e ndryshimeve në rendin ndërkombëtar, sfidat në funksionimin shumëpalësh të botës, ndryshimi në administratën amerikane dhe kriza e brendshme e BE-së pas negociatave të Brexit-it, si dhe roli i fuqive të mëdha (SHBA dhe Rusi) ndërkohë që dialogu me Serbinë po i afrohet fundit, kanë përcaktuar mënyrën si e perceptojnë të anketuarit kosovarë qëndrimin e shteteve të listuara kundrejt Kosovës.

Në Kosovë, përvjetori i dhjetë i pavarësisë solli në rend të ditës procesin e krijimit të partneriteteve strategjike dhe pozicionimit ndërkombëtar. QKSS-ja ka vazhduar të matë perceptimin e qytetarëve ndaj aktorëve kryesorë global, disa me ndikim të drejtpërdrejtë në politikën e jashtme të Kosovës duke pasur parasysh rolin e tyre në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, disa madje me rol vendimtar në kompletimin ndërkombëtar të shtetësisë.

Lista e shteteve të renditura në këtë seksion ka mbetur e pandryshuar. Sërish, reagimet cilësore konfirmojnë se perceptimet ndaj këtyre shteteve janë të rrënjosura në pozicionimin e përgjithshëm të këtyre shteteve kundrejt Kosovës si shtet, intensitetin e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën dhe nivelet e përkrahjes apo kundërshtimit ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në këtë pjesë, perceptimet rrallë bazohen në përvoja personale, siç ishte e rastit me shtetet e rajonit. Rrjedhimisht, nuk duhet të injorohet roli i mediave si krijues kyç të opinionit. Këtë vit, ndryshe nga edicionet e mëparshme të BKS-së, i anketuari mesatar i ka dhënë përgjigjet nën ndikimin e debateve mbi shkëmbimin e territoreve me Serbinë, prandaj opinioni ishte shumë i bazuar në qëndrimin e secilit shtet në raport me këtë temë. Në retrospektivë, ky edicion konfirmon qasjen "pro-perëndimore" në Kosovë, megjithëse entuziazmi ka rënë pak. Opinioni publik (duke përjashtuar komunitetin serb në disa raste) mbetet mjaft pozitiv ndaj fuqive perëndimore dhe ka qëndrim pozitiv ndaj BE-së dhe NATO-s. Me sa duket, për Rusinë dhe Kinën, të cilat shihen si partnerë strategjikë nga shtete të tjera në rajon, opinioni i përgjithshëm publik në Kosovë mbetet negativ.

2.1. Kosova dhe SHBA: perceptimet publike ndaj ndikimit të SHBA-ve në Kosovë nën administratën e re

Kur iu kërkua të cilësojnë qasjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) ndaj Kosovës, shumica e të anketuarve, një përqindje solide prej 86.0, besojnë fuqishëm se SHBA është partneri kyç strategjik për Kosovën. Në retrospektivë, të gjitha edicionet e BKS-së i kanë renditur SHBA-të mes shteteve më miqësore ndaj Kosovës. Reagimet cilësore tregojnë se ky perceptim është zhvilluar në vitin 1999 pas rolit proaktiv dhe kyç të SHBA-ve në sigurimin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Përveç kësaj, përkrahja diplomatike e ofruar në procesin e shtet-ndërtimit e ka forcuar më tej qëndrimin pozitiv ndaj SHBA-ve. Së fundi, por jo për nga rëndësia, këtë vit rezultatet e BKS-së tregojnë se të anketuarit i shohin marrëdhëniet Kosovë - SHBA përtej kornizës së marrëdhënieve dypalëshe konvencionale; ShBA-të perceptohen më shumë si një nga aleatët më të mëdhenj dhe partner strategjik i Kosovës. Është me rëndësi vendimtare të përmendet fakti që ndryshe nga edicionet e mëparshme, të anketuarit janë deklaruar haptazi në favor të përfshirjes më të madhe të SHBA-ve në procesin e dialogut me Serbinë. Një shumicë e madhe e të anketuarve besojnë se vetëm SHBA-të kanë aftësi politike që t'i japin fund me sukses këtij procesi. Përveç kësaj, mbështetja e SHBA-ve



Figura 8 - Perceptimet ndaj SHBA-ve



Figura 9 - Ndikimi i SHBA-ve në Kosovë

në përpjekjet për të përfunduar transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në forca të armatosura, ka pasur një ndikim të madh në formësimin e qëndrimit pozitiv në mesin e të anketuarve.

Qëndrimi neutral ndaj SHBA-ve, 5.1 për qind, lidhet me administratën e re dhe perceptimin e përgjithshëm se SHBA-të janë larguar nga rajoni, duke e lënë çështjen e Kosovës në duart e BE-së. Ndërkaq, perceptimi negativ prej gati 8.0 për qind është kryesisht i pranishëm në mesin e të anketuarve nga pakica serbe - një perceptim që ndahet për fuqitë e tjera perëndimore në përgjithësi.

Tendencë e ngjashme e perceptimeve u vërejt kur iu kërkua të vlerësojnë ndikimin e SHBA-ve në Kosovë, dhe një pjesë shumë e madhe e të anketuarve, gjegjësisht 91.3 për qind prej tyre, deklaruan se ndikimi i SHBA-ve në Kosovë është shumë pozitiv. Ky ndikim është perceptuar të jetë shumëdimensional, duke përfshirë edhe ndikimet politike, ekonomike dhe kulturore. Sidoqoftë, këtë vit ky perceptim është bazuar gjerësisht në faktin se IHD-të më të mëdha në fushën e energjisë në Kosovë vijnë nga një prodhues i energjisë elektrike nga SHBA, ContourGlobal, me vlerë rreth 1.3 miliardë euro. Ky investim ka qenë një nga temat më të transmetuara në media dhe ka ndikuar në mënyrë pozitive në opinionin publik.

2.2. Kosova dhe Gjermania: aleati më i madh politik në kuadër të BE-së?

Mes të gjitha shteteve të renditura në këtë seksion, Gjermania është cilësuar si shteti me qasjen më miqësore ndaj Kosovës. Rezultatet e BKS 2018 e rendisin Gjermaninë në krye të të gjitha shteteve të BE-së, me 89.6 për qind të të anketuarve që perceptojnë Gjermaninë si aleatin kryesor strategjik në kuadër të BE-së. Një nga faktorët kryesorë që qëndron pas këtij perceptimi pozitiv rrjedh nga qasja e "tregut të hapur të punës" që Gjermania ka promovuar në Kosovë. Kohët e fundit, Gjermania ka futur një lloj të ri vize, e ashtuquajtura vizë për punëkërkues, duke ofruar mundësi që profesionistët e rinj të kualifikuar nga Kosova t i zhvillojnë karrierat e tyre në Gjermani. Teksa kjo qasje ka kontribuar më tej në rritjen e dukurive të ikjes së trurit, ajo ka pasur një ndikim të madh në zbutjen dhe uljen e papunësisë në Kosovë. Gjermania, është parë si një nga shtetet kryesore investuese në Kosovë, por gjithashtu si një nga kontribuesit kryesorë në të ardhurat e vendit nëpërmjet remitancave. Prania në shkallë të gjerë e diasporës kosovare në Gjermani ka luajtur një rol thelbësor në zhvillimin e një qasjeje të tillë pozitive.

Përveç faktorëve që lidhen me ekonominë, Gjermania është parë si aleati kryesor politik i Kosovës në kuadër të BE-së. Në mesin e të gjitha shteteve të BE-së, Gjermania ka qenë më e zëshme në rolin e saj në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe me kushtëzimin që ka imponuar ndaj Serbisë në lidhje me rastin e Kosovës. Për më tepër, qëndrimi i fortë i Gjermanisë kundrejt epilogut të dialogut Kosovë-Serbi dhe idesë së shkëmbimit të territoreve, është renditur ndër faktorët kryesorë pas qasjes masive pozitive ndaj këtij shteti.

Në këtë linjë, kur u pyetën për nivelin dhe llojin e ndikimit gjerman në Kosovë, rreth 86.6 për qind e të anketuarve besojnë se është pozitiv, pasuar nga një përqindje shumë e vogël që e percepton ndikimin gjerman si negativ. Në këtë rast, është e rëndësishme të përmendim faktin se roli i Gjermanisë është parë edhe në kontekstin e pranisë së BE-së në Kosovë, marrë parasysh faktin se Gjermania është një nga lojtarët kyç kur flitet për rajonin.



Figura 10 - Perceptimet ndaj Gjermanisë



Figura 11 - Ndikimi i Gjermanisë në Kosovë

2.3. Kosova dhe Turqia: ndikim i strukturuar dhe intensiv

Marrëdhëniet dypalëshe me Turqinë kanë qenë vazhdimisht pjesë e debatit publik në Kosovë. Në disa raste Turqia është perceptuar si aleat me Perëndimin, duke qenë pjesë e NATO-s, kurse në raste të tjera është promovuar si "alternativa tjetër" ndaj perëndimit, veçanërisht ndaj BE-së, dhe kjo për shkak të marrëdhënieve të turbulluara të kohëve të fundit mes Turqisë dhe BE-së, më konkretisht me disa nga shtetet kyçe anëtare.

Kur iu kërkua të cilësojnë qasjen e Turqisë ndaj Kosovës, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve, pothuajse 70.0 për qind e tyre, besojnë se është partner miqësor ndaj Kosovës. Reagimet cilësore nga të anketuarit konfirmojnë se perceptimi i tyre pozitiv vjen nga ndjenja fetare dhe kulturore. Lëvizshmëria e rritur me Turqinë, që mbetet një nga shtetet më të mëdha ku kosovarët mund të udhëtojë pa viza, e ka ushqyer më tej këtë qasje pozitive. Tregtia dhe bashkëpunimi ekonomik është perceptuar përmes një prizmi pozitiv, dhe në këtë rast përqindja e ulët e Investimeve të Huaja Direkte (FDI) në Kosovë ka krijuar perceptimet se Turqia është investitori më i madh në Kosovë. Kur dekonstruktojmë perceptimin ndaj Turqisë, është shumë e rëndësishme të përmendet se përqindja e atyre që e



Figura 12 - Perceptimet ndaj Turqisë



Figura 13 - Ndikimi i Turqisë në Kosovë

perceptojnë si shtet pozitiv ka rënë me 5.0 për qind që nga viti 2017. Faktorët që qëndrojnë pas kësaj rënie janë shumë të lidhur me rastin e gjashtë qytetarëve turq të arrestuar në Kosovë për lidhjet e tyre me organizatën e Gylenit dhe të ekstraduar në Turqi me kërkesën e presidentit turk[1]. Deportimet u konsideruan si ndërhyrje direkte e regjimit aktual turk në Kosovë. Për më tepër, procesi i dyshimtë i deportimit filloi të dukej gjithnjë e më shumë si rrëmbim i pastër, duke u kthyer në shembull të kërcënimit të paraqitur nga shpërfillja e Turqisë për normat ndërkombëtare dhe për Kosovën, në këtë rast. Deportimi i shtetasve turq, me banim të ligjshëm në Kosovë, ka ngjallur debate të mëdha, dhe u pasua nga dorëheqjet e Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Më shumë se 1/4 e të anketuarve duket se ishin më ngurrues në lidhje me Turqinë. Kur u pyetën rreth qasjes së Turqisë ndaj Kosovës, rreth 17 për qind e qytetarëve zgjodhën të mbeten neutralë. Asnjanësia e tyre buron nga dyshimi që lidhet me ndikimin e strukturuar të regjimit

1 Bytyçi, F. (2018, mars 29). Gjashtë turq të arrestuar në Kosovë për lidhje me Gylenin të ekstraduar në Turqi... Qasur më 9 dhjetor 2018, në https://www.reuters.com/article/us-turkey-security-kosovo/six-turks-arrested-in-kosovo-over-gulen-links-extradited-to-turkey-anadolu-idUSKBN1H51JL

aktual turk në Kosovë dhe agjendën e mundshme islamike pas investimeve turke. Tendencat e presidentit turk për të rifituar rëndësinë në ish-territoret osmane duke përdorur Kosovën dhe Bosnjë dhe Hercegovinën janë të dukshme, dhe kjo është konsideruar si një agjendë shumë e kushtueshme politike nga ata që kanë zgjedhur të mbeten neutralë ose që shfaqën perceptim negativ (pothuajse 10.0 për qind) ndaj Turqisë. Përveç kësaj, kriza e brendshme politike dhe ekonomike në Turqi ka pasur një ndikim negativ në rajon dhe Kosovë, dhe kjo është pasqyruar në perceptimet e përgjithshme ndaj këtij shteti. Pavarësisht hezitimeve dhe dyshimeve në lidhje me Turqinë, shumica e të anketuarve, rreth 80.0 për qind, kanë deklaruar se ndikimi i Turqisë në Kosovë është shumë pozitiv.

2.4. Kosova dhe Mbretëria e Bashkuar: a do ti kemi në krahun tonë?

Roli i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë vazhdon të jetë shumë aktiv në shumë nivele. Mbretëria e Bashkuar ka bërë përpjekje të gjera për të forcuar sundimin e ligjit në Kosovë, duke kontribuar në agjendën e përgjithshme të reformave të BE-së në Kosovë. Për më tepër, bashkëpunimi dypalësh në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes nuk mund të kalojë pa u vënë re nga publiku më i gjerë, veçanërisht kur flitet për mundësitë e ofruara për anëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, shumë prej të cilave paraqiten gjerësisht në media.

Mbretëria e Bashkuar është renditur tradicionalisht mes shteteve me qëndrim pozitiv ndaj Kosovës. Nga ana statistikore, afërsisht 80.0 për qind e të anketuarve e shohin qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar ndaj Kosovës përmes një prizmi pozitiv. Mbështetja e vazhdueshme dhe lineare e Mbretërisë së Bashkuar është renditur si faktor kyç nga ata që i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetjeje. Për më tepër, Mbretëria e Bashkuar është parë si aleate strategjike, përkrahëse e fortë dhe e zëshme e Kosovës në arenën ndërkombëtare, kryesisht duke iu referuar mbështetjes



Figura 14 - Perceptimet ndaj Mbretërisë së Bashkuar

së ofruar në proceset në vazhdim të anëtarësimit në platformat shumëpalëshe ndërkombëtare. Teksa disa besojnë se me largimin e Mbretërisë së Bashkuar nga BE-ja Kosova ka humbur një partner strategjik kyç në kuadër të BE-së, një përqindje e madhe e të anketuarve janë optimistë për bashkëpunimin e përmirësuar në nivel dypalësh. Për rrjedhojë, shumë qytetarë deklaruan se presin më shumë programe dypalëshe që përqendrohen në forcimin e procesit të shtet-ndërtimit në Kosovë.

Nga ana tjetër, 10 për qind e të anketuarve kanë zgjedhur të mbeten neutralë. Kjo përgjigje ka qenë shumë e lidhur me Brexit-in dhe mungesën e kapaciteteve të Mbretërisë së Bashkuar për të ofruar për shtetet e treta, tani që është angazhuar në negociata në vazhdim për largimin nga BE-ja. Ata që ndanin perceptim neutral apo madje lehtësisht negativ kujtonin Samitin e Londrës të Ballkanit Perëndimor, komunikimin dhe suksesin e tij të vakët në shtyrjen e agjendës së BE-së për rajonin, duke përfshirë këtu edhe Kosovën.

2.5. Kosova dhe Franca: në kërkim të dinamikave të reja

Në edicionet e mëparshme të BKS-së, opinioni publik ndaj Francës është treguar mjaft i luhatshëm. Kur iu kërkua të cilësojnë qëndrimin e Francës ndaj Kosovës, gjysma e të anketuarve u deklaruan se e perceptojnë si pozitive. Qëndrimi ndaj Francës u zhvillua gjatë luftës dhe u sfidua menjëherë pas luftës, kur Mitrovicës u nda nën mbikëqyrjen e trupave franceze të KFOR-it. Reagimet cilësore të marra direkt nga të anketuarit krijojnë supozimin se ata presin një qasje më proaktive të Francës në raport me Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Në aspektin statistikor, rreth 58.0 për qind besojnë se Franca ka qëndrim solid ndaj Kosovës.

Përqindja e atyre që mbeten neutralë në qëndrimin e tyre ndaj Francës është mjaft e lartë, rreth 27 për qind e të anketuarve besojnë se Franca është neutrale ndaj Kosovës. Kjo qasje mund t'i atribuohet rolit modest të Francës në promovimin ose mbështetjen e nismave diplomatike të iniciuara nga Kosova. Për më tepër, kjo qasje mund t'i atribuohet mbështetjes që Franca i dha idesë së shkëmbimit të territoreve dhe mungesës së vullnetit politik në Francë për ta shtyrë përpara procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën.



Figura 15 - Perceptimet ndaj Francës

2.6. Kosova dhe Rusia: mes armiqësisë dhe ndikimit negativ

Rusia paraqet një nga pengesat kryesore për Kosovën në arenën ndërkombëtare. Në sytë e të anketuarve, Rusia përputhet me Serbinë dhe fuqia e saj e vetos në KS të OKB-së po e mban Kosovën larg nga një prej objektivave më të mëdhenj politikë që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008. Përveç rolit destruktiv të Rusisë në lidhje me Kosovën në arenën ndërkombëtare, ndikimi i Rusisë, kryesisht përmes partisë serbe në Kosovë "Lista Serbe", është renditur nga të anketuarit si një arsye kyçe për qëndrimin negativ ndaj Rusisë.

Kur iu kërkua të cilësojnë qasjen e Rusisë ndaj Kosovës, rreth 80.4 për qind e perceptojnë si shtet shumë armiqësor ndaj Kosovës. Prirja negative, ngjashëm me edicionet e mëparshme të BKS-së, u atribuohet lidhjeve të ngushta diplomatike mes Rusisë dhe Serbisë. Përveç qasjes negative të njohur gjerësisht ndaj Kosovës në arenën ndërkombëtare, një tjetër çështje shqetësuese është ndikimi i lartë politik i Rusisë në rajon, të cilin e përdorur si një bazë solide për të ndërhyrë me SHBA-të dhe BE-në. Si e tillë, Rusia ka qenë kryesisht e shqetësuar me forcimin e



Figura 16 - Perceptimet ndaj Rusisë

pozitës së saj në çështjet me BE-në dhe SHBA-në, dhe nga kjo pikëpamje, çështja e Kosovës i ka shërbyer në mënyrë të përkryer një ambicieje të tillë.

Ndikimi i Rusisë në Kosovë, megjithëse jo i drejtpërdrejtë për shkak të mungesës së njohjes, në sytë e qytetarëve është konsideruar se realizohet përmes Serbisë, më saktësisht përmes partisë politike Lista Srpska në Kosovë, e cila i merr direktivat nga Beogradi. Për më tepër, mbështetja e vazhdueshme nga Rusia i ka dhënë Serbisë një pozicionim të mirë negociues dhe një gur të fortë kundrejt BE-së. Ky pozicionim është konsideruar si faktori kyç i përfitimeve politike të kufizuara deri në inekzistente për Kosovën nga ky proces.

Kështu, kur u pyetën për ndikimin rus në Kosovë, rreth 78.0 per qind e të anketuarve besojnë se është shumë i dëmshëm dhe kryesisht politik. Çka është më e rëndësishmja në sytë e opinionit publik, Rusia dhe Serbia mbështesin njëra tjetrën në mënyrë që të ushqejnë ambicien e tyre për të ruajtur ndikimin në Kosovë, por edhe që të mbizotërojnë në të gjithë rajonin.

Opinionet pozitive në lidhje me qasjen e Rusisë ndaj Kosovës pasqyrohen në mesin e anketuarve serbë të Kosovës, konkretisht me 8.7 për qind. Ky perceptim është zhvilluar në bazë të qëndrimit të Rusisë ndaj Kosovës dhe partneritetit me Serbinë.



Figura 17 - Ndikimi i Rusisë në Kosovë

Kush po përfiton më shumë?



Impakti i Asociacionit të Komunave Serbe



A mendoni që shkëmbimi i territoreve ofron zgjidhjen afatgjate me Serbinë?



KAPITULLI /3

DIALOGU ME SERBINË:
Lëvizja drejt etapës finale

Dialogu i lehtësuar nga BE-ja përbën shtyllën kryesore në politikën e jashtme të Kosovës. Para fillimit të dialogut me Serbinë, Kosova kishte administruar një politikë të jashtme të pavarur, në të cilën Serbia përfaqësonte vetëm një segment të saj. Sot, politika e jashtme e Kosovës varet plotësisht nga rezultatet e dialogut me Serbinë. Kjo përfshin njohjet ndërkombëtare, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, për shembull procesin e votimit të kohëve të fundit të Interpolit, si dhe fenomenin e fundit të tërheqjes së njohjeve. Për më tepër, ky proces ka pasur pasoja të mëdha në funksionimin e brendshëm të vendit, stabilitetin politik dhe sigurinë e tij. Fërkimet mes elitës politike në Kosovë, tensionet dhe frika nga përshkallëzimi i mundshëm i situatës në pjesën veriore të vendit, janë renditur si shqetësime kryesore nga të anketuarit.

Për gjashtë vjet dhe pas marrëveshjeve të shumta në të ashtuquajturin dialog teknik dhe politik me Serbinë, një pyetje është ngritur gjerësisht nga opinioni publik në Kosovë, çka do të thotë normalizim? Dialogu, të paktën në gjuhën e burokratëve të BE-së, që fillimisht kishte për qëllim normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, është kthyer në një modalitet për parandalim të konflikteve. Marrëveshjet që synonin të lehtësonin jetët e qytetarëve kontribuan vetëm për një status quo më të fortë dhe për situatën e konfliktit të ngrirë. Në retrospektivë, sa më shumë i afrohemi vijës së finishit, aq më larg jemi nga normalizimi. Pas gjashtë vjetësh, Kosovës janë duke iu ofruar tri alternativa të rrezikshme: 1) status quo, që përfundimisht do ta kthente Kosovën në modalitet të mbijetesës pa të ardhme në arenën ndërkombëtare, 2) Asociacioni i Komunave me shumicë serbe - një skenar i mundshëm i Republika Srpska dhe 3) shkëmbim tokash që përfaqëson një marrëveshje shumë të guximshme dhe të rrezikshme me plan të paqartë dhe mungesë të mekanizmave të forta dhe vullnetit politik për t'u zbatuar me sukses. Teksa dialogu i BE-së po shkon drejt fundit dhe të gjitha alternativat janë larg nga çka Kosova priste që të fitonte politikisht, opinioni publik dhe elita politike në Kosovë nuk ka qenë kurrë më të përçarë.

Duke qëndruar në prag të zgjedhjeve të parakohshme, manovrat e partive politike dhe udhëheqësve të tyre përmbajnë shumë kalkulime, kurse disa nuk ngurrojnë të përdorin retorikën nacionaliste për të fituar më shumë mbështetje dhe vota. Kështu, mosmarrëveshja e vazhdueshme me Serbinë siguron një rrugë solide dhe të rehatshme për politikanët që të shmangin diskutimin e çështjeve të tjera politike, sociale dhe ekonomike. Luajtja e kartës nacionaliste i siguron lidershipit aktual një mundësi që të mbetet në pushtet për sa kohë që mosmarrëveshja me Serbinë mbetet e pazgjidhur.

Duke përcjellë trendet e tilla shqetësuese në kuadër të dialogut, QKSS-ja vazhdoi të matë perceptimet e publikut kundrejt këtij procesi, ndërkohë që u përfshinë pyetje të reja për t'u përshtatur me rrjedhat e reja të dialogut. Rezultatet si dhe reagimet e të anketuarve reflektojnë nivele të larta të mosbesimit ndaj rolit të BE-së si lehtësues dhe ndaj rezultateve përfundimtare të këtij procesi në përgjithësi.

3.1. Fitimtarët dhe humbësit e dialogut

Palët negociuese nga Kosova dhe Serbia gjithmonë kthehen si triumfatorë nga Brukseli. Çdo raund i dialogut dhe marrëveshjet e nënshkruara në Bruksel kanë ndezur një konkurrencë të madhe se kush është fituesi më i madh i raundit. Dykuptimësia konstruktive dhe mungesa e transparencës nga lehtësuesi dhe të dyja palët në dialog krijuan një terren pjellor dhe mundësi unike politike për secilën palë që ta shpallte veten si fitues. Mungesa e transparencës çoi në keqkuptime mes qytetarëve, dhe formulimi diplomatik i BE-së, së bashku me mediat e njëanshme lokale të kontrolluara nga qeveria, nuk siguruan informacion të mjaftueshëm për publikun e gjerë. Për më tepër, armiqësia që të dyja palët kanë shprehur ndaj njëra tjetrës në proces e ka forcuar më tej armiqësinë mes qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë.

Figura 18 - Perceptimet për rezultatin e dialogut



Kur pyeten se kush përfiton më shumë nga dialogu, në mesin e të anketuarve është shumë e pranishme një tendencë për të renditur palën tjetër si fitimtare. Paranoja kolektive e krijuar nga mungesa e transparencës ka krijuar perceptimin se dialogu po sjell përfitime politike vetëm për "kundërshtarët". Andaj, pothuajse gjysma e të anketuarve kanë deklaruar se Serbia po përfiton më shumë se Kosova në këtë proces. Argumentet pas kësaj qasjeje u bazuan në faktin se Serbia po e përdor dialogun si një rrugë e lehtë për përparim në procesin e integrimit në BE, ndërsa Kosova ende përpiqet të fitojë njohje të plotë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Si rrjedhojë, vetëm 13.4 për qind e të anketuarve besojnë se Kosova po përfiton nga dialogu. Qasja asimetrike e BE-së, agjenda e qartë e vitit 2025 për Serbinë dhe perspektiva e paqartë e BE-së kanë kontribuar më tej në zhvillimin e kësaj perceptimi.

Më shumë se një e katërta e të anketuarve, 25.7 për qind që të jemi të saktë, besojnë se dialogu nuk zhvillohet për përfitim as Kosovës e as të Serbisë. Reagimet cilësore tregojnë se të anketuarit besojnë se ky proces nxitet gjerësisht nga BE-ja, e cila kërkon një histori suksesi në ndërmjetësimin ndërkombëtar dhe rritjen e rolit të vet si ofrues i paqes dhe sigurisë. Ndërkaq, një përqindje e vogël e të anketuarve, 8.0 për qind, besojnë se të dyja palët përfitojnë nga procesi, duke iu referuar kryesisht marrëveshjes së lëvizjes së lirë, e cila është zbatuar me sukses edhe pse e kufizuar.

3.2. Asociacioni i komunave serbe: Skenari i Republika Srpska për Kosovën?

Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe (AKSHS) u nënshkrua nga të dyja palët në gusht 2015, nën patronazhin e fazës politike të dialogut. Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje ka shkaktuar debate të ashpra ndërmjet elitave politike në Kosovë. Ndërkaq, zbatimi i saj pothuajse ka shkaktuar konflikte të reja mes Kosovës dhe Serbisë. Frika nga konflikte të mundshme është shfaqur në mënyrë sporadike pas nismës së njëanshme nga serbët lokalë për të krijuar AKSHS-në me ndihmën e Beogradit.

Figura 19 - Perceptimet ndaj Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë



Në sytë e të intervistuarve shqiptarë të Kosovës, AKSHS-ja shihet si një skenar i Republikës Srpska për Kosovën. Për më tepër, ka ngritur shqetësime mbi ndikimin e ardhshëm në funksionimin e brendshëm të Kosovës, duke u perceptuar si plani i Beogradit për të zgjeruar ndikimin e vet politik në Kosovë. Ky argument është forcuar me praninë e "Listës Serbe" që punon sipas direktivave të Beogradit, prandaj Asociacioni me fuqi ekzekutive do të "instrumentalizohej" me shpejtësi nga Beogradi me qëllim që t i ndërpresë nga brenda proceset politike në Kosovë. Për më tepër, një asociacion i ndarë mbi baza etnike do të kontribuonte në izolimin e mëtejshëm të serbëve të Kosovës nga shqiptarët e Kosovës, pra do të jetë kundër shtetit multietnik të përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës. Marrë parasysh faktorët e lartpërmendur, pothuajse 80.0 për qind e të anketuarve besojnë se AKSHS-ja përbën rrezik të drejtpërdrejtë për funksionimin e brendshëm të Kosovës si shtet.

Ndryshe nga shumica e të anketuarve shqiptarë të Kosovës, të anketuarit serbë, rreth 5.0 për qind, besojnë se Asociacioni do të ketë ndikim Pozitiv në Kosovë. Qëndrimi pozitiv ndaj AKSHS-së pasqyron pritshmëritë që komuniteti lokal serb ka ndaj këtij mekanizmi. Duke qenë të përjashtuar nga dialogu, edhe pse përdoren gjerësisht për pazare nga Kosova dhe Serbia, serbët e Kosovës besojnë se ky mekanizëm do t'i realizojë më në fund pritshmëritë e tyre.

Rreth 15.6 për qind e të anketuarve besojnë se është neutral. Në pjesën më të madhe të kohës, opsioni neutral në vlerësim tregon mungesën e informacionit, ose mungesën e aftësisë për të parashikuar se çfarë do të sjellë Asociacioni, gjithashtu tregon se të anketuarit nuk kanë informacion në lidhje me të. Për këtë, ndikim të rëndësishëm ka pasur qasja e dykuptimësisë konstruktive e BE-së.

3.3. Kush duhet t'i japë drejtim?

Kush do ta udhëheqë Kosovën drejt vijës së finishit? Kjo çështje po e mundon opinionin publik në Kosovë. Fillimi i fazës politike të nivelit të lartë të dialogut kërkoi që "burrat e fortë" të përfshiheshin në proces. Duke qenë të përfaqësuar nga presidentët, si Kosova ashtu edhe Serbia kanë hyrë në fazën kritike të dialogut. Megjithatë, ndërkohë që nuk ka shumë debate për monopolin politik dhe përkrahjen që gëzon presidentit serb Aleksandër Vuçiq, debatet e fundit në Kosovë e kanë vënë në pikëpyetje përkrahjen që gëzon Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka në këtë proces.

Debati për kryenegociatorin u përshkallëzua më tej pas Forumit Alpbach, ku të dy presidentët paraqitën zyrtarisht idenë e tyre për korrigjimin e kufijve / shkëmbimin e territoreve si një zgjidhje e mundshme afatgjatë për mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi. Pas kësaj ngjarjeje politike të nivelit të lartë të BE-së, mes elitave politike dhe opinionit publik u ndez mosbesimi ndaj Presidentit Thaçi, dhe në Kuvend janë ndërmarrë disa përpjekje të pasuksesshme, të

paqarta politikisht dhe naive për t□ia hequr presidentit këtë "privilegj".

Në përcjellje të këtij trendi, QKSS-ja ka krijuar një pyetje të hapur të krijuar për të marrë alternativën e parë të ofruar nga qytetarët si përgjigje të vlefshme dhe të pavarur. Vendimi për ta lënë këtë pyetje të hapur ishte i qëllimshëm për dy arsye: 1) t□u lejohej të anketuarve të ishin krijues në përgjigjet e tyre dhe të shmangej parashikimi ose ndikimi i përgjigjeve, dhe 2) nga pikëpamja metodologjike, pyetjet e hapura mund të japin informata më të sinqerta, jashtë mendimit standard, dhe njohuri krijuese dhe unike për hulumtuesit. Të anketuarve iu kërkua të rendisin individët që duhet të udhëheqin dialogun me Serbinë. Siç është treguar në rezultatet, të anketuarit janë mjaft të ndarë mes disa udhëheqësve politikë, institucioneve shtetërore dhe elitave jo-politike. Teksa në Serbi pozicioni i Presidentit Vuçiq është i padiskutueshëm, në Kosovë Presidenti Thaçi nuk posedon të njëjtin nivel komforti.

Figura 20 - Kush duhet t'i udhëheqë negociatat me Serbinë?



Siç e tregon grafiku, opinioni publik është shumë i ndarë dhe ambivalent kur pyetet për kryenegociatorin. Rreth 80.0 për qind e qytetarëve i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, dhe mes tyre vetëm rreth 15.0 për qind besojnë se dialogu duhet të udhëhiqet nga Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi. Reagimet cilësore tregojnë se të anketuarit që e kanë renditur Presidentin Thaçi si udhëheqës në dialog, i përkrahin përpjekjet e tij politike në përgjithësi. Pak më pak mbështetje ka marrë Albin Kurti nga partia politike Vetëvendosje, me 11.5 për qind të të anketuarve që besojnë se është shumë i aftë dhe në gjendje ta udhëheqë dialogun. Fakti që shumica dërrmuese e të anketuarve kanë sugjeruar udhëheqës në vend të institucione shtetërore, si Qeveria me 4.24 për qind dhe Kuvendi me 5.71 për qind, është një tregues kyç i domosdoshmërisë për të pasur "burra të fortë" në proces. Për më tepër, përqindja e ulët e atyre që besojnë se ky proces mund të udhëhiqet me sukses nga Kuvendi ose Qeveria, korrespondon me besimin e ulët të qytetarëve ndaj këtyre institucioneve. Kryeministri aktual Ramush Haradinaj mori vetëm 3.5 për qind, duke reflektuar qartë mungesën e përfshirjes së tij proaktive në këtë proces. Një përqindje e vogël e të anketuarve, me saktësisht 3.2 për qind, shfaqën dëshirën për një qasje të unifikuar të të gjithë krerëve/partive politike kundrejt Serbisë përmes Ekipit të Unitetit.

Vlen të përmendet një qasje inovative e të anketuarve që listojnë elitat intelektuale jo politike me 7.19 për qind, Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës me 2.3 për qind, çka tregon se të anketuarit po kërkojnë alternativa përtej atyre aktuale dhe personave që tashmë janë përfshirë drejtpërsëdrejti në dialog, e sidomos përtej politikanëve që nuk kanë hezituar ta përdorin dialogun për përfitimet e tyre politike.

3.4. Finalja e madhe: shkëmbimi i tokave që çon në zgjidhje të qëndrueshme?

Në gusht, në një ngjarje mjaft të orkestruar dhe me përkrahësit e tyre të ulur në radhët e para, Presidentët e Kosovës dhe Serbisë propozuan zgjidhjen e mosmarrëveshjen të gjatë përmes shkëmbimit të territoreve. Ndërkohë që nuk ka siguri për planin e saktë, pasi nuk është zbuluar asnjëherë, shumë ide janë dhënë nga Presidenti i Kosovës pas Alpbach-ut. Masterplani që supozohet se do të siguronte një zgjidhje afatgjatë, përfshin komunat me popullsi serbe në pjesën veriore të Kosovës dhe qytetet me popullsi shqiptare në pjesën jugore të Serbisë, dhe kjo është një nga alternativat e shumta.

Kjo ide ka ngjallur shumë debate, dhe ndërkohë që shumë studiues ndërkombëtarë të Ballkanit janë përpjekur të tregojnë argumentet e tyre pro dhe kundër kësaj zgjidhjeje, në Kosovë opinioni publik kaloi nga reagimi i tronditur në mosmiratim dhe pastaj në pranim të heshtur. Shkëmbimi i territoreve u pa si agjendë e drejtuar nga Serbia, dhe fakti që është mbështetur publikisht nga Presidenti i Kosovës erdhi si goditje për opinionin publik në Kosovë.

Në pyetjen nëse shkëmbimi i territoreve do të sigurojë një zgjidhje afatgjatë, shumica dërrmuese e të anketuarve, gati 81.0 për qind e qytetarëve, kanë deklaruar se kjo nuk do të arrihet. Argumenti kryesor i përgjigjes negative, pavarësisht urgjencës për të arritur një marrëveshje me Serbinë, është mungesa e besimit për ndërmarrjen e një veprimi kaq serioz me Serbinë. Nga ana tjetër, reagimet cilësore tregojnë se nuk është zbuluar informacioni bazë që ka të bëjë me planin për të zbatuar një marrëveshje të tillë të rrezikshme. Andaj, implikimet e mundshme për jetët e qytetarëve nuk do të mund të parashikoheshin në këtë pikë. Përveç kësaj, të anketuarit kanë ngritur pyetjen e thjeshtë, si dhe kush? Nëse kjo marrëveshje do të shtyhet përpara, si do të zbatohet dhe kush do të sigurojë zbatimin e plotë të saj. Në sytë e të anketuarve, BE-së i mungojnë kapacitetet për të garantuar zbatimin e një marrëveshje të tillë politikisht të ndjeshme. Ky perceptim është bazuar në pamundësinë e BE-së për të siguruar zbatimin e marrëveshjeve më të thjeshta teknike.

Nga ana tjetër, pavarësisht të gjitha rreziqeve, rreth 9.0 për qind kanë shfaqur opinion pozitiv për këtë marrëveshje. Duke treguar një shenjë të qartë të ndikimit nga mediat dhe konferencat e shtypit të Presidentit të Kosovës, kur u pyetën se cilat territore do të shkëmbehen për të arritur paqen e shumëpritur, shumica dërrmuese e atyre që thanë po deklaruan se do të ishte e pranueshme të shkëmbehej ndonjë territor i Kosovës veriore me qytetet shqiptare në jug të Serbisë. Qëndrimi pozitiv ka qenë i pranishëm kryesisht në të anketuarit serbë të Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës. Reagimet cilësore tregojnë se serbët e Kosovës në jug të lumit Ibër ngurrojnë ta pranojnë këtë marrëveshje. Duke qenë të vetëdijshëm se ndryshimi në përbërjen etnike brenda Kosovës do ta shfuqizonte politikisht paketën e Ahtisaarit me të gjitha privilegjet për pakicën serbe, kjo humbje e rëndësisë politike dhe e përfitimeve të siguruara nga kjo paketë mund të jenë të kushtueshme për serbët e mbetur në Kosovë.

Figura 21 - A mendoni që shkëmbimi i territoreve ofron zgjidhjen afatgjate me Serbinë?



Figura 22 - A mendoni që shkëmbimi i territoreve ofron zgjidhjen afatgjate me Serbinë?



Atyre që i janë përgjigjur po idesë për shkëmbim të territoreve, QKSS-ja u ka paraqitur një pyetje të hapur shtesë për të marrë më shumë reagime dhe për të testuar cili shkëmbim i territoreve është i pranueshëm për të anketuarit. Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, ka një tendencë për konfuzion në lidhje me territoret që mund të shkëmbehen, pasi kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e njerëzve. Për disa, pjesa veriore e Kosovës është strategjikisht e rëndësishme për Kosovën, kryesisht për shkak të minierës së Trepçës dhe Liqenit të Ujmanit, burimi kryesor i ujit për Kosovën.

Në përgjithësi, përgjigjet ofruan një mesazh kyç për rolin e fortë të mediave dhe ndikimin që diskursi politik i Presidentit Thaçi ka pasur mbi të anketuarit. Shumica dërrmuese e atyre që e mbështetën këtë ide kanë përcjellë çka është transmetuar nga gushti, pra pjesa veriore e Kosovës (me disa që e kufizojnë vetëm me Leposaviqin dhe Zveçanin) dhe Lugina e Preshevës (ose në disa raste edhe Bujanoci). Ka zëra që kërkojnë mbrojtjen e minierës së Trepçës dhe Liqenit të Ujmanit, pa e ditur saktësisht se çfarë do të sjellë kjo marrëveshje. Duke u gjetur në një situatë të zymtë, shumë të anketuar shfaqën hezitim që të japin përgjigje në këtë pyetje.

Figura 23 - Nëse po, cilët territore duhet të shkëmbehen?



KAPITULLI 4

KOSOVA DHE MULTILATERALIZMI:
A jemi gati?

Që nga shpallja e pavarësisë, politika e jashtme e Kosovës e ka përqendruar agjendën e saj në dy rryma të ndryshme, e para për të fituar më shumë njohje ndërkombëtare, dhe e dyta e përqendruar në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare dhe platformat e bashkëpunimit.

Besohet se anëtarësimi i suksesshëm në organizatat shumëpalëshe do ta konsolidojë më tej shtetësinë e Kosovës ndërkombëtarisht. Ambicia për t'u anëtarësuar në këto struktura ndërkombëtare shumëpalëshe dhe ndërqeveritare, përkatësisht BE dhe NATO, ka qenë pjesë integrale e agjendës së politikës së jashtme, edhe pse vetëm formalisht. Kundrejt këtij sfondi, QKSS-ja e konsideroi shumë të rëndësishme të masë perceptimet e publikut ndaj strukturave më të rëndësishme euro-atlantike. Rezultatet e BKS 2018 konfirmojnë se opinioni publik përputhet me qeverinë në Kosovë, duke shfaqur mbështetje të fortë për anëtarësimin në platformat ndërkombëtare shumëpalëshe.

4.1. Kosova dhe BE-ja: a po bën qeveria përpjekje të mjaftueshme?

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova e ka kthyer integrimin në BE në një nga prioritetet kyçe të politikës së vet të jashtme. Njëkohësisht, procesi i integrimit në BE nuk mund të konsiderohet vetëm në kontekstin e politikës së jashtme për shkak të ndikimit të tij të rëndësishëm në funksionimin e brendshëm të vendit në vazhdën e agjendës së reformave të BE-së dhe procesit të harmonizimit të politikave me BE-në.

Duke bërë përparim gjatë viteve të fundit në përpjekjet për t'u afruar më shumë me Bashkimin Evropian, kryesisht duke iu referuar Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në, Kosova u përpoq të vazhdojë të shtrojë rrugën drejt anëtarësimit në BE. Sidoqoftë, strategjia e BE-së "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe angazhimit më të madh të BE-së me Ballkanin Perëndimor", konfirmoi perspektivën e BE-së për shtetet e tjera në rajon, ndërkohë që e la Kosovën me një rrugë të paqartë drejt BE-së, që supozohet se do të hapet sapo ta lejojnë rrethanat objektive.

Neutraliteti i statusit të BE-së dhe perspektiva e paqartë e anëtarësimit të vendit, të shoqëruar me pamundësinë e BE-së për ta vënë dialogun mes Kosovës dhe Serbisë në rrugën e duhur dhe me qasjen "zvarritëse" në procesin e liberalizimit të vizave, ishin shkaku i disa ankesave në mesin e të anketuarve . Pa marrë parasysh ngecjet dhe pengesat, BE-ja perceptohet si e vetmja alternativë, pavarësisht se mbetet një "qëllim i largët" për Kosovën.

Figura 24 - Perceptimi i punës së qeverisë drejt BE-së



Në përcjellje të diskursit pro integrimit në BE në Kosovë dhe agjendës së BE-së që u përkrah gjerësisht gjatë dhjetë viteve të fundit nga secila qeveri, pavarësisht nga orientimi politik i partive në pushtet, QKSS-ja përfshiu një pyetje specifike me qëllim mbledhjen e perceptimeve mbi përpjekjet politike dhe punën proaktive të qeverisë aktuale për të zbatuar reformat e nevojshme brenda kufijve të kushtëzimit të BE-së.

Kur u pyetën nëse qeveria aktuale është duke ndërmarrë përpjekje dhe duke punuar në mënyrë adekuate për përmbushjen e reformave kyçe në procesin e integrimit në BE, më shumë se gjysma e të anketuarve apo një në dy të anketuar, ose 55.1 për qind saktësisht, janë përgjigjur negativisht. Në rastin e Kosovës, shumicë dërrmuese e reformave janë të lidhura me zbatimin e MSA-së dhe procesin e liberalizimit të vizave. Reagimet cilësore nga hulumtimet në terren tregojnë se perceptimi negativ nuk është i lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e MSA-së, për shkak të nivelit të ulët të të kuptuarit të këtij procesi mes qytetarëve. Megjithatë, ekziston një perceptim se qeveria ka dështuar në informimin e qytetarëve mbi progresin e prekshëm të arritur që nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje të rëndësishme ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Ata që u përgjigjën negativisht në këtë pyetjeje, kanë theksuar nivelet shqetësuese të korrupsionit dhe performancën e dobët e qeverisë, me gjithë numrin më të lartë të ministrave dhe zëvendësministrave në histori.

Përkundrazi, 32.2 për qind e të anketuarve besojnë se qeveria ka punuar në mënyrë proaktive për ta çuar vendin përpara në agjendën e integrimit në BE. Qasja pozitive ka ardhur kryesisht nga raporti pozitiv i Komisionit Evropian për përmbushjen e të gjitha kritereve të përfshira në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në retrospektivë, ata që janë përgjigjur pozitivisht besojnë se qasja e BE-së për liberalizimin e vizave është e padrejtë. Dështimi i BE-së për të mbajtur premtimet që i atribuohen politikës së "bukës" pas "gurit", pas përpjekjeve politike për të arritur marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, është konsideruar si një dështim i BE-së.

Rreth 13.0 për qind e të anketuarve hezituan të japin opinione në lidhje me këtë. Mungesa e informatave solide mbi agjendën e integrimit në BE dhe detyrat e qeverisë në lidhje me këtë proces, janë renditur si arsyet kryesore në përgjigjen e tyre.

4.2. Kosova dhe NATO: përtej bashkëveprimit të zgjeruar

Në kuadër të proceseve të integrimit euro-atlantik, Kosova e ka vendosur integrimin në NATO si prioritet kyç kombëtar, së pari në vitin 2014 me fillimin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë të Kosovës. Që atëherë, Kosova ka arritur të bëjë një lëvizje shumë të lehtë lineare në procesin tepër të ndërlikuar të integrimit në NATO. Ndërveprimi i zgjeruar mes NATO-s dhe Kosovës nisi në fillim të vitit 2017, duke arritur shumë më pak se programi i Partneritetit për Paqe që synonte Kosova. Përkundër hapit të hedhur drejt arritjes së objektivit të integrimit në NATO, bashkëveprimi i zgjeruar nuk mund të lidhet drejtpërdrejt me qëndrimin pozitiv të qytetarëve për shkak të mungesës së informacionit në lidhje me këtë proces në mesin e të anketuarve.

Ngjashëm me edicionet e kaluara, opinioni i përgjithshëm publik ndaj anëtarësimit në NATO mbetet shumë pozitiv. Mbi 82 për qind e të anketuarve kanë deklaruar se janë pro anëtarësimit në NATO. Qëndrimi pozitiv ndaj NATO-s është thellësisht i rrënjosur në ndërhyrjen ushtarake në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999, pasuar nga misioni i KFOR-it në Kosovë, cili ende mbetet një nga ofruesit më të besueshëm të sigurisë në Kosovë[2]. Përveç kësaj, partneriteti i fortë me Kroacinë dhe Shqipërinë (të dy anëtarë të NATO-s nga rajoni) në sektorin e mbrojtjes, e ka forcuar më tej qasjen pozitive.

Nga ana tjetër, rreth 11.0 për qind e të anketuarve përgjithësisht e kundërshtojnë anëtarësimin në NATO; perceptimi negativ është i pranishëm kryesisht në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës, të cilët e kundërshtojnë fuqishëm integrimin e Kosovës në NATO.

Figura 23 - Perceptimet ndaj anëtarësimit në NATO



Kjo mund të shpjegohet me faktin se në përputhje me politikën e Beogradit, të anketuarit serbë e kundërshtojnë NATO-n, duke shfaqur qartë preferencën për të forcuar partneritetin në sektorin e mbrojtjes me Rusinë.

Rreth 7 për qind e të anketuarve shqiptarë kanë shfaqur një hezitim të vogël në lidhje me debatin mbi transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës. Çka është më e rëndësishmja, deklaratat e zyrtarëve të NATO-s në lidhje me këtë proces kanë krijuar perceptime të përziera mes të anketuarve shqiptarë. Për më tepër, ata që nuk dëshironin të ndanin opinionin e tyre për NATO-n nuk kishin informacion rreth aleancës, duke e parë atë vetëm përmes misionit të KFOR-it të pranishëm në Kosovë.

2 Marku, D. (2018, 23 nëntor). Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i Tetë - Raportet. Qasur më 26 nëntor 2018, në http://www.qkss.org/en/Reports/Kosovo-Security-Barometer-Eighth-Edition-1163

METODOLOGJIA

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i posaçëm i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), e cila është themeluar në shtator të vitit 2012. Fokusi i tij parësor është matja e besimit të publikut ndaj institucioneve të sigurisë, drejtësisë dhe atyre qendrore në Kosovë, si dhe matja e perceptimit të qytetarëve për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë.

BKS-ja është punimi i parë dhe më i madh i këtij lloji i projektuar, zbatuar dhe komunikuar nga një qendër studimore lokale në Kosovë. Çka e bën BKS-në unike në Kosovë, është neutraliteti i tij politik. Si qendër studimore e pavarur, QKSS-ja nuk ka kufizime politike në komunikimin e ndonjë prej gjetjeve dhe mesazheve të anketës.

BKS-ja kombinon metoda sasiore dhe cilësore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat mblidhen përmes intervistave sy më sy me të anketuarit e përzgjedhur rastësisht në të gjithë Kosovën nga hulumtuesit e QKSS-së në terren. Pyetësori i BKS-së përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura që i lejojnë të anketuarve të japin mendimet e tyre pa mundësi të paracaktuara.

Mostrimi, pilotimi dhe intervistat janë realizuar nga 28 hulumtues në terren të ekipeve të QKSS-së. Mostra kombëtare nga e cila u hartua hulumtimi paraqet 1,085 ekonomi familjare, pas mostrimit përfaqësues të popullsisë mbi 18 vjeç në Kosovë.

Përkatësia etnike e të anketuarve ishte 90% shqiptarë të Kosovës, 8% serbë të Kosovës dhe 2% të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptas, goranë, kroatë dhe malazezë), duke pasqyruar përbërjen etnike të Kosovës.

Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodit telefonik, dhe si të tilla përfshihen 8 rajonet e mëposhtme: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren.





Faza e parë e grumbullimit gjeografik u bazua në Raportin e Regjistrimit të Kosovës të vitit 2012. Faza e dytë përfshiu grupimin e mostrave sipas zonës së komunës me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit përdori metodën e mostrës së rastësishme duke përdorur metodën e datëlindjes më të afërt.

Marrja e mostrave të rastit siguron që çdo banor në Kosovë ka probabilitet të barabartë për të qenë i zgjedhur për një intervistë. Duke pasur parasysh mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë prirjet në qëndrimet dhe perceptimet në mesin e të gjithë popullsisë së rritur në Kosovë në përgjithësi. Marzha e gabimit është 3% me një interval besueshmërie prej 95%.

Para fillimit të punës në terren u krye një intervistë pilot në mes të shtatorit 2018 për të testuar realizueshmërinë e pyetësorit. Më pas, ekipi hulumtues raportoi se intervista pilot ishte e suksesshme, dhe nuk kishte probleme me instrumentin pilot. Të gjitha intervistat u kryen nga 29 shtatori deri në 5 tetor 2018. Për më tepër, përpunimi dhe analiza e të dhënave u realizua duke përdorur softuerin SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të mbledhura nga të anketuarit dhe demonstrojnë mënyrën si ata i perceptojnë institucionet kosovare.

Të anketuarit sipas gjinisë



Të anketuarit sipas vendbanimit



Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)
32(497.11:496.51)(048)

Barometri kosovar i sigurisë : dekonstruktimi i perceptimeve publike Politika e Jashtme e Kosovës dhe dialogu me Serbinë / Donika Emini. – Prishtinë : Kosovar Center for Security Studies, 2018. - 35 f. : ilsustr. me ngjyra ; 21 cm.

1.Emini, Donika

ISBN 978-9951-679-88-6

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-88-6